


# Tregu i Punës 2021

**Tiranë, më 23 Maj 2022:** Bazuar në vlerësimet e Anketës së Forcave të Punës, gjatë vitit 2021, numri i personave në forcën e punës është rreth 1.411.308 persona. Femrat përbëjnë 44,6 % të forcës së punës dhe meshkujt 55,4 %. Të punësuar janë 1.248.749 persona, ku femrat përbëjnë 44,5 % të të punësuarve dhe meshkujt 55,5 %. Numri i të papunëve vlerësohet të jetë 162.560 persona, ndër të cilët 45,5 % janë femra dhe 54,5 % janë meshkuj.

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për popullsinë 15-64 vjeç është 69,3 %. Për meshkujt e moshës 15-64 vjeç shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 15,9 pikë përqindje më e lartë sesa për femrat.

Shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 60,9 %. Shkalla e punësimit për femrat është 53,8 % dhe për meshkujt 68,2 %. Hendeku gjinor në punësim për këtë grup-moshë është 14,4 pikë përqindje në favor të meshkujve.

**Fig.1 Shkalla e punësimit sipas grup-moshave, 2020-2021**




Sektori i shërbimeve dhe sektori bujqësor kanë përqindjen më të lartë të të punësuarve me përkatësisht 44,3 % dhe 33,8 % të të punësuarve gjithsej. Në vitin 2021, rezulton se 47,9 % e të punësuarve janë të punësuar me pagë, 32,0% janë të vetë-punësuar (punëdhënës ose të vetëpunësuar pa të punësuar të tjerë) dhe 20,1 % janë punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes.

Shkalla zyrtare e papunësisë në vitin 2021, për popullsinë 15 vjeç e lart, është 11,5 % dhe shënon një ulje me 0,2 pikë përqindje krahasuar me vitin 2020. Për meshkujt, shkalla e papunësisë është 0,5 pikë përqindje më e ulët sesa për femrat.

Shkalla e papunësisë për të rinjtë e moshës 15-24 vjeç është 27,1 % (25,5 % për meshkujt dhe 29,2 % për femrat). Krahasuar me vitin pararendës, shkalla e papunësisë së të rinjve është rritur me 0,6 pikë përqindje.

**Fig.2 Shkalla e papunësisë sipas grup-moshave, 2020-2021**




Burimi: INSTAT, Anketa e Forcave të Punës

Në vitin 2021, të rinjtë e moshës 15-29 vjeç të cilët nuk janë të punësuar dhe nuk janë duke ndjekur shkollën apo ndonjë formim profesional përbëjnë 26,1 % të të rinjve gjithsej.

Në grupin e të rinjve që nuk janë të punësuar dhe nuk janë as duke ndjekur shkollën apo ndonjë formim profesional, 37,3 % klasifikohen si të papunë. Pjesa tjetër, janë jashtë tregut të punës për arsye se janë ose të dekurajuar (15,4 %), ose duke përmbushur detyra dhe përgjegjësi familjare (17,5 %), ose për arsye të tjera (29,8 %).

**Fig. 3 Të rinjtë (15-29 vjeç) jo në punësim dhe as duke ndjekur shkollën, sipas statusit në tregun e punës dhe gjinisë, 2021**




Burimi: INSTAT, Anketa e Forcave të Punës

### Qarqet

Një analizë mbi baza rajonale, tregon që në vitin 2021, qarqet me shkallë punësimi më të lartë janë: Gjirokastra (65,6 %) dhe Elbasani (62,2 %). Ndërsa qarqet me shkallë punësimi më të ulët janë qarku i Lezhës (36,6 %) dhe i Dibrës (42,7 %). Qarqet me shkallë papunësie më të lartë janë qarku i Lezhës (22,6 %) dhe i Vlorës (19,5 %), ndërsa qarqet me papunësi më të ulët janë Kukësi (4,0 %) dhe Gjirokastra (4,7%).

Në vitin 2021, Tirana është qarku me numrin më të lartë të të punësuarve në sektorin e shërbimeve (68,7 %), Durrësi është qarku me numrin më të madh të punonjësve të angazhuar në sektorin e industrisë (39,4 %), ndërsa qarku me numrin më të lartë të të punësuarve në sektorin e bujqësisë është Kukësi (69,6 %).

Fig. 4 Struktura e punësimit sipas qarqeve dhe sektorëve të ekonomisë, 2021



Burimi: INSTAT, Anketa e Forcave të Punës

### Pagat

Në vitin 2021, paga mesatare bruto për një të punësuar me pagë në Shqipëri është 57.191 lekë. Krahasuar me vitin 2020, paga mesatare mujore bruto për një të punësuar në Shqipëri u rrit me 6,6 %.

Paga mesatare mujore bruto është mbi nivelin mesatar për aktivitetet ekonomike si: Aktivitetet Financiare dhe të sigurimit, Informacioni dhe komunikacioni, Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm; arsimi; shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale.


Ndërsa aktivitetet ekonomike me pagë poshtë nivelit mesatar janë: Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave; transporti dhe magazinimi; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor; dhe Bujqësia, Silvikultura dhe Peshkimi.

Hendeku gjinor në paga është 4,5 %. Hendeku gjinor në paga është më i theksuar mes punonjësve që janë të punësuar në ndërmarrjet që i përkasin grup-aktivitetit ekonomik "Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar; furnizimi me ujë; aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit", ku arrin vlerën 29,4 %.

## Tregu i Punës 2021

Gjatë vitit 2021, 32,7% e kontribuesve në kategorinë e të punësuarve me pagë marrin një pagë mesatare mujore bruto deri në nivelin e pagës minimale zyrtare. Për vitin 2021, paga minimale zyrtare është 30.000 lekë.

**Fig.5 Shpërndarja e kontribuesve të punësuar me pagë sipas grupimeve të pagës mesatare mujore bruto, 2021**



Në vitin 2021, grup-profesionet më të paguara janë: Manaxherët, Ligjvënësit, nëpunësit e lartë të administratës shtetërore dhe drejtorët ekzekutivë; Specialistët me arsim të lartë (profesionistë); dhe Teknikët dhe specialistët në zbatim. Ndërsa grup-profesionet me pagë nën nivelin mesatar janë: Punonjës të kualifikuar të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit; punëtorët e profesioneve elementare; dhe zejtarët, artizanët dhe profesione të lidhura me to.

# Metodologjia

**Shkalla e punësimit:** Numri i personave të punësuar në moshë 15 deri 64 vjeç pjesëtuar me popullsinë në moshë 15 deri 64 vjeç.

**Shkalla zyrtare e papunësisë:** Numri i personave të papunë të moshës 15 vjeç e lart pjesëtuar me numrin e personave në forcën e punës (të punësuar e të papunë) të të njëjtës grupmoshë.

**Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës:** numri i personave në moshë 15 deri 64 vjeç në forcën e punës pjesëtuar me numrin e popullsisë në moshë 15 deri 64 vjeç.

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës dhe shkalla e punësimit llogariten për popullsinë e moshës 15 deri në 64 vjeç. Ndërsa shkalla e papunësisë llogaritet për popullsinë ekonomikisht aktive (ndryshe forca e punës) të moshës 15 vjeç e lart. Shkallët e punësimit dhe të pjesëmarrjes në forcat e punës të llogaritura mbi popullsinë 15 vjeç e lart ndikohen nga përfshirja e personave në pension në emërues dhe kështu janë më pak kuptimplotë sesa shkallët e llogaritura për popullsinë e moshës 15-64 vjeç. Ndërsa, në llogaritjen e shkallës së papunësisë për popullsinë 15 vjeç e lart, në emërues kemi popullsinë ekonomikisht aktive, e cila përfshin personat e punësuar ose në kërkim aktiv të një pune dhe të aftë për punë, dhe si rrjedhojë ky tregues nuk ndikohet nga popullsia mbi moshën e pensionit.

**Paga mesatare mujore bruto** llogaritet për të punësuarit kundrejt pagës dhe përfshin: pagën bazë, shtesat mbi pagë për: (a) funksione drejtuese; (b) vjetërsi në punë; (c) vështirësi në punë; dhe (d) shtesa të tjera të rregullta (tituj, grada etj.). Në pagën mesatare bruto nuk zbriten kontributet personale dhe tatimi mbi të ardhurat.